

SYLLABUS i Lëndës: **Ekonomiksi i Shëndetisë** - Niveli MASTER

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Ekonomiksi i Shëndetisë
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	1
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	<i>Prof.Asoc.Dr.Driton Qehaja</i>
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Ekonomia Shëndetësore është një fushë që në vitet e fundit i kushtohet një rëndësi e veçantë. Çështjet e politikave publike që kanë të bëjnë me këtë sektor kanë rritur rëndësinë pasi kujdesi shëndetësor i kushtohet vemendje e veçantë vitve të fundit. Në këtë kurs, do të përdorim modele ekonomike për të analizuar tregjet e kujdesit shëndetësor dhe për të shqyrtuar çështjet e lidhura me politikat publike. Do të përdoren metoda nga mikroekonomia për të analizuar se si funksionojnë aspekte të ndryshme të sistemit të kujdesit shëndetësor. Ne do të përdorim modele dhe teknika ekonomike nga disiplinat e ekonomisë së informacionit, organizimit industrial, ekonomisë së punës, ekonomisë publike, ekonomisë së sjelljes dhe teorisë së vendimeve për të analizuar çështjet e kujdesit shëndetësor. Qëllimet kryesore të kursit do të jenë (i) Studentët të zotërojnë modelet e ndryshme ekonomike në kontekstin e tregjeve të kujdesit shëndetësor dhe (ii) Studentët të njihen me hollësitë specifike institucionale dhe politikat relevante për ato tregje.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kursit është që studentët të kuptojnë mbi konceptet kyçe në ekonomi dhe për të ofruar njohuri për zbatimin e parimeve ekonomike në politikat shëndetësore. Objektivat e mëtejshme të këtij kursi janë: (1) të zhvillojë një kuptim të rëndësisë së koncepteve ekonomike në sektorin e kujdesit shëndetësor, (2) për të përshkruar sistemin e financimit dhe ofrimit të kujdesit shëndetësor në sektorin e kujdesit shëndetësor, dhe (3) të japë një kuptim të rolit të faktorëve

	ekonomikë në zhvillimin e politikës publike në lidhje me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studentët duhet të jenë në gjendje të: 1) Kuptojnë se si ofrimi i kujdesit shëndetësor ndryshonë nga ofrimi i produkteve të tjera të konsumit. 2) Përdorimi i modeleve mikroekonomike për të kuptuar dhe analizuar elementet bazë dhe dinamikën e tregjeve të kujdesit shëndetësor dhe të sigurimeve shëndetësore. 3) Përdorimi i analizës kosto-përfitim për të vlerësuar teknologjitë dhe ndërhyrjet e ndryshme mjekësore. 4) Kuptojnë arsyet ekonomike për ndërhyrjen e qeverisë në tregjet e kujdesit shëndetësor dhe vlerësojnë rolin e qeverisë si pagues dhe rregullator. 5) Krahasojnë sistemet e kujdesit shëndetësor të vendeve të tjera të zhvilluara		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	4	5	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	4	16
Projektet, prezentimet ,etj	1	15	15
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
Çdo javë mbahen nga 2 orë ligjërata. Pas çdo ligjërate jepen detyra për përgatitjen e eseve, të cilat diskutohen në javën në vijim. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në vend,			

	gazetat, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim. Esetë e përgatitura lidhur me këto çështje merren parasysh në vlerësim. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupe, me komente mbi ligjëratën/prezantimin e mësimdhënësit.
Metodat e vlerësimit:	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë vitit, nota përfundimtare është rezultat i aktivitetit të studentëve të treguar gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, vlerësimeve paraprake dhe një provimi përfundimtar. Pyetja do të jetë me shkrim. Pyetjet formulohen prej materialit mesimorë që ligjrohet në klase dhe kanë formën e pyetjeve të shkurtra dhe /ose në forme të tjera. Menyra e vlerësimit: • 10 % të notës finale - Pjesëmarrje aktive në klasë. • 10% të notës finale - Zhvillimi dhe prezantimi i punimit seminarik. • 80% të notës finale - Dy teste që përfaqësojnë: ○ 40% të notës finale - Testi i parë (Testi i parë përfshinë rreth 50% të materialit mesimor) ○ 40% të notës finale - Testi i dytë (Testi i dytë përfshinë rreth 50% të materialit mesimor) • Nuk ka nevojë që të nenshtroheni testit final NESE kalohen dy testet, dhe nëse jeni të rregullt dhe aktiv në ligjerata, si dhe nëse zhvilloni punimin seminarik. • Nëse nuk kaloni njerin nga testet e parapara, keni mundësi ta perseritni vetëm një herë, njerin nga testet që nuk keni kaluar. Nëse edhe herën e dytë, nuk e kaloni njerin nga testet e parapara, do të nenshtroheni testit final-testit të përgjithshëm. • Testi final: për të kaluar testin e përgjithshëm, studentet duhet që të arrijnë së paku 51% të pikëve të parapara. Koment: nëse nuk kalohen testet, nuk merret parasysh pjesëmarrja aktive në klase e as punimi seminarik.

	Gjatë vlerësimit do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: - interpretimi i temës, - thellësia e të kuptuarit të temës, - shfrytëzimi i literaturës, - evaluimi dhe sinteza e evidencës, - analizat kritike dhe - logjika e ndërtimit të argumentit. Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim do tu kushtohet edhe: - drejtshkrimin, - prezantimin vizual të të dhënave dhe referencave, - gjatësisë së shkrimit dhe - prezantimit të përgjithshëm.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Health Economics, Theories, Insights and Industry Studies, 6th Edition by R.E. Santerre and S.P. Neun (S&N), South-Western Cengage Learning, 2013Massachusetts: MIT Press. ISBN 9780262025539. 2. The Economics of Health and Health Care, 8th ed. (2017) by Sherman Folland, Allen C. Goodman, and Miron Stano; New York, NY: Routledge
Literatura shtesë:	• Health Economics and Financing, Thomas E. Getzen, 5th Edition • Henderson, James W. Health Economics and Policy (South-Western Cengage Learning, Mason, OH 2011). Feldstein, Paul J. Health Policy Issues: An Economic Perspective (Health Administration Press, Chicago 2011) Artikujë në revista shkencore: • Fuchs, Victor R. "What is Health Economics?" In The Future of Health Policy. Boston: Harvard University Press, pp. 27-40. • Grossman, Michael. 1972. On the Concept of Health

	Capital and the Demand for Health. <i>Journal of Political Economy</i> 80 (2): 223–255. • Angus Deaton. 2013. <i>The Great Escape</i>, Princeton University Press. Chapter 1. • Cutler, D. “The Simple Economics of Health Reform,” <i>The Economists’ Voice</i>, December 2010. • Aaron, H. and P. Ginsburg. 2009. “Is Health Spending Excessive? If So, What Can We Do About it?” <i>Health Affairs</i>, 28(5): 1260-1275. • Thomas, Duncan et al. (2006). "Causal Effect of Health on Labor Market Outcomes: Experimental Evidence," mimeo, UCLA. • Bleakley, C. Hoyt. 2010a. Health, Human Capital, and Development. <i>Annual Review of Economics</i>, 2:283–310. • Cutler, David M. and Grant Miller. 2005. The Role of Public Health Improvements in Health Advances: The Twentieth-Century United States. <i>Demography</i>. 42(1): 1-22. • Miguel, Edward, and Michael Kremer (2004). “Worms: Identifying Impacts on Education and Health the Presence of Treatment Externalities”, <i>Econometrica</i>, 72(1), 159-217. • Weisbrod, Burton A. 1991. "The Health Care Quadrilemma: An Essay on Technological Change, Insurance, Quality of Care, and Cost Containment." <i>Journal of Economic Literature</i>, 29 (1991): 523-552. • Kremer, Michael, “Pharmaceuticals and the Developing World,” <i>Journal of Economic Perspectives</i>, 16(4): 67–90, 2002. WWW Burimet: The Morning Consult http://themorningconsult.com/ The Incidental Economist http://theincidentaleconomist.com/ The Health Care Blog http://thehealthcareblog.com/blog/tag/economics/ The Health Care Economist http://healthcare-economist.com/
--	--

Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Përmbledhja e lendes dhe bazat e mikroekonomisë
<i>Java e dytë:</i>	Një pasqyrë e përgjithshme industrisë së sistemit shëndetësor
<i>Java e tretë:</i>	Shëndetësia, kujdesit mjekësor dhe shpenzimet për shëndetesi
<i>Java e katërt:</i>	Kërkesa për shërbimet shëndetësore
<i>Java e pestë:</i>	Prodhimi dhe Kostot e Kujdesit Mjekësor
<i>Java e gjashtë:</i>	Analiza Kosto-Benefit
<i>Java e shtatë:</i>	Struktura, sjellja dhe performanca e tregut të sistemit shëndetësor
<i>Java e tetë:</i>	Industria e Sigurimeve Shëndetësore
<i>Java e nëntë:</i>	Industria Farmaceutike
<i>Java e dhjetë:</i>	Ofrimi i Sigurimeve Shëndetësore nga Qeveria
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Organizimi i Tregjeve të Sigurimeve Shëndetësore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kujdesi Shëndetësor, Tregjet e Punës dhe Trajnimi Profesional
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Industria Farmaceutike
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Ndërhyrja e qeverisë në tregjet e kujdesit shëndetësor
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Diskutimet dhe vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat e Fakultetit. Studentet duhen të respektojnë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID-së studentore në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.